

Sherri në Rrogozhinë, arrestohen 3 të plagosurit, shpallet në kërkim autori

© 09/03/2021 - 11:09



Policia e Kavajës ka arrestuar për tentativë vrasje 3 të lënduarit nga sherri që ndodhi ditën e djeshme më 8 mars në fshatin Sinaballaj në Rrogozhinë.

Në prangat e policisë kanë rënë vëllezërit Jurgen dhe Ervin Juba, Klajdi Lluca dhe është shpallur në kërkim autori i plagosjes së 3 personave, Albi Juba.

Sipas burimeve, ai është nga Peqini dhe shok me 3 të plagosurit.

Konflikti mes 4 personave ka nisur për motive banale çka çoi deri në përdorimin e armës së zjarrit dhe të sendeve të forta.

“Nga specialistët për Hetimin e Krimin në Komisariatin e Policisë Kavajë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve E. J., 27 vjeç, J. J., 24 vjeç, dhe K. Ll., 22 vjeç, si dhe u shpall në kërkim A. J., 29 vjeç, pasi në fshatin Sinaballaj, Rrogozhinë, gjatë një konflikti të çastit për motive të dobëta, fillimisht me sende të forta dhe më pas duke përdorur armë zjarri, janë dëmtuar me armë zjarri shtetasi K. Ll. dhe E. J., si dhe është dëmtuar me sende të forta shtetasi J. J., të cilët ndodhen në spital, nën kujdesin e mjekëve. Punohet për kapjen e shtetasit A. J,” njoftimi i plotë i policisë.

Lexo edhe: [Plumba në Rrogozhinë, sherri përfundon me 3 të plagosur, rëndë 22-vjeçari Klajdi Lluca](#)

Tags

ARRESTOHEN

RROGOZHINE

SHERRI

Artikull joetik?

raporto këtu



Ora

Ora News



HAP LLOGARI BANKARE


ONLINE NË 15 MINUTA

#ZGJEDHJE-2021

Sondazhi II Kombëtar



Goci: Në listat e PD-së nuk ka asnjë nga Lëvizja për Teatrin



Aurela Basha nostalgjike, poston foton e para disa viteve me



Valteri: Ju bashkova PS-së me ftesë të Ramës si forcë fituese,



Listat: Gratë “me zor”, “të fortët” me dëshirë




VIDEO/ Ballokume nga duart e Kryemadhit, kryetarja e LSI



Italia bllokon një seri vaksinash të AstraZeneca-s për hetim

Sondazhi

Kë do të votoni më 25 prill?



ME TË LEXUARAT

- Valteri: Ju bashkova PS-së me ftesë të Ramës si forcë fituese,
- VIDEO/ Ballokume nga duart e Kryemadhit, kryetarja e LSI
- “Qenke budalla i madh ti!” Kryebashkiaku Veliaj e humb
- “Jam Grida Duma” Malaj shpërthen ndaj Ramës:
- Bregu “premtim” Veliajt: Siç luftuam miun e arrave, ashtu do